

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMITNr. 2458/3 Prot.Durrës, më 27.10 .2025

V E N D I M

Nr. 83 , Datë 27.10 .2025

P Ë R

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL 2- VJEÇAR NË "SPECIALIST I MBROJTJES SË
KONSUMATORIT DHE I LEGJISLACIONIT USHQIMOR", PRANË FAKULTETIT
TË STUDIMEVE PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR
MOISIU" DURRËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin e UAMD-së ; në Rregulloren e UAMD-së ; në shkresën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore të FSP me nr. 2099 prot., datë 17.09.2025, si edhe në relacionin Nr. 2099/1 prot., datë 06.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, vendimin e Senatit Akademik nr.116, datë 24.10.2025, Bordi i Administrimit

V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifës së programit të studimit me karakter profesional 2- vjeçar në "Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe i Legjislacionit Ushqimor", pranë Departamentit të Studimeve të Integruara me Praktikën, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027.